



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

VENDIM

Nr. 19 datë 13/10/2020

**“PËR DHËNIEN E TITULLIT “DOCTOR HONORIS CAUSA”, ZNJ. MARIE
THÉRÈSE PORTER ROYCE”**

Bazuar në ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 3, neni 38 pika 3, të Statutit të UT-së, neni 31 pika “t” dhe në Kreun V, pika 1, të VKM-së nr. 112, datë 23.2.2018 " Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore "Doktor" dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademik "Profesor i Asociuar" dhe "Profesor" si dhe në propozimin e ardhur nga Fakulteti i Shkencave Sociale, Senati Akademik i Universitetit të Tiranës,

VENDOSI:

1. Të japë titullin “*Doctor Honoris Causa*” për zonjën Marie Thérèse Porter Royce, Ndhimëse Sekretare e Departamentit të Shtetit për Çështjet e Arsimit dhe Kulturës, SHBA me motivacionin: “Për kontribut të shquar në forcimin e marrëdhënieve midis dy vendeve në fushën e arsimit dhe kulturës, në përfshirjen e gjerë të personelit akademik dhe studentëve të Universitetit të Tiranës në programet e Departamentit të Shtetit me ndikim të lartë në formimin akademik dhe profesional, në fuqizimin e rolit të grave në shoqëri si dhe në ruajtjen e trashëgimisë kulturore në Shqipëri”.
2. Të caktojë reçentë Prof. Dr. Artan Hoxha dhe Prof. Asoc. Dr. Sonila Papathimiu.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARLI SENATIT AKADEMIK

PROF. DR. ARTAN HOXHA